

**AKT THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“Skydream Service” SHPK**

Ortaku i vetëm themelues:

- **Z. Jorgo Nezha**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 22.11.1982, lindur në Lushnje dhe banues në Karbunare, Skilaj, Lushnje, Shqiperi, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës Nr. I21122015L.

bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, sot më datë 14.03.2022, hartojnë këtë Akt Themelimi të shoqërisë si më poshtë vijon;

**NENI 1**

***Emri***

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar mban emrin “**Skydream Service**” SHPK  
Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

**NENI 2**

***Forma***

Shoqëria tregtare “**Skydream Service**” SHPK ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

**NENI 3**

***Zyra Qendrore***

3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “**Skydream Service**” SHPK, do të ketë zyrën e saj qendrore në Shqipëri, Njesia Bashkiake nr 5, Rruga Donika Kastrioti 3, Kisha Apostolike e Re, Hyrja 2, Kati i 1, Apt.1, Nr. 1, Tirane, Shqipëri.

3.2 Ndryshimi i zyrës qendrore të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

**NENI 4**

***Objekti i Veprimtarisë***

Objekt i veprimtarisë së shoqërisë është: Sherbim konsulence në investime jashtë dhe brenda vendit, shitblerje e pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme, investimeve publike dhe private, sigurinë e jetës dhe jo jetës, në sigurim në kantierë punimesh ose prodhimesh, në fushën e kërkimeve për studime investimesh, kërkime dhe analize tregu për investim, konsulence marketingu online-off-line, prodhimin shkëmbimor dhe publikimin e libra revista studime shkencore, konsulence financiare, konsulence politike, konsulence kinematografisë. Konsulence për llogaritë demet e shaktuar ndaj të tjerëve, konsulence e investimeve strategjike dhe makroekonomike, konsulence ndërtim-zbatim e mirëmbajtje rrjeti teknologjisë. Konsulence në fushën e ciberkrimeve. Konsulence marketingu dhe reklamimi. kërkimet e tregut, identifikimin e konkurrencës dhe gjetjen e konsumatorëve. Shitjen e hapësirave publitare për publikimet e veta dhe për llogaritë të tjerëve, edhe nëpërmjet agjencive dhe ose shoqërive të tjera, organizimin e konferencave, kongreseve, seminareve si dhe të gjitha aktiviteteve në lidhje me marketingun. Shoqëria mund të kryejë menaxhimin e buxheteve publitare. Ndërmjetësimi në fushën e marketingu online dhe offline, për blerje jashtë dhe brenda vendit për individ dhe biznese, menaxhim për llogaritë të tjerëve e marrëdhëniet me publikun, ndërmjetësim për llogaritjen dhe rekuperimin e borxheve të keqija, ndërmjetësim legale për palet në konflikt ose jo.



**NENI 5**  
***Kohëzgjatja***

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë të pacaktuar.

**NENI 6**  
***Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit***

Shoqëria tregtare “Skydream Service” SHPK mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

**NENI 7**  
***Përgjegjësia e Ortakëve***

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë “Skydream Service” SHPK dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara prej tyre.

**NENI 8**  
***Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat***

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “Skydream Service” SHPK është 100.000 (njqindmije) lekë, i cili është nënshkruar dhe derdhur rregullisht nga ortaku i vetem Z. Jorgo Nezha

**NENI 9**  
***Organet e Shoqërisë***

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

**NENI 10**  
***Administratori***

Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohen dhe shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje. Administrator i Shoqërisë është Z. Jorgo Nezha.

**NENI 11**  
***Sekretit tregtar***

Ortaku, administratori dhe punëmarrësit e shoqërisë “Skydream Service” SHPK përgjigjen ndaj shoqërisë për dëmin e shkaktuar nga përhapja e sekreteve tregtare, për të cilat kanë dijeni, për shkak të kryerjes së funksioneve të tyre në shoqëri.

**NENI 12**

Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim secili prej ortakëve ka të drejtë t’i drejtohet për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**ORTAKU I VETEM THEMELUES**

Jorgo Nezha

  
\_\_\_\_\_